

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AS CONSTRUCTION SH.P.K.

DATË 08.07.2019

Sot, në datën 08.07.2019, ne te nënshkruarit:


- Z. Aleksandër FRANGAJ, i datëlindjes 04.10.1968, lindur në Zejmen, Lezhë dhe banues në adresën: Kompleksi Rolling Hills, Mullet, Tiranë, identifikuar me anë të pasaportës me numër personal G81004099S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Dhe

- Balfin Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 025864525, ne përputhje me Vendimin e Ortakut te Vetëm nr. 15 date 02.07.2019.

në cilësinë e Ortakeve themelues, vendosen të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "AS CONSTRUCTION" SH.P.K.. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëlidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 - Emërtimi



- 1.1 Shoqëria emërtohet AS CONSTRUCTION SH.P.K., (në vijim "Shoqëria").

Neni 2 – Forma

- 2.1 Shoqëria AS CONSTRUCTION SH.P.K., themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe Aktit të saj të Themelimit.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 3 – Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresë Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tirane Shqiperi.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe njësi vendore të çdo lloji. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale dhe/ose agjencive.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
- Investime ne fushën e pasurive te paluajtshme dhe ndërtimit;
 - Projektim, mbikëqyrje dhe zbatim i punimeve ndërtimore te çfarëdolloj.
 - Ofrimi i shërbimeve te konsulencës ne fushën e menaxhimit dhe marketimit te pasurive te paluajtshme;



- d. Ndertime dhe rikonstruksione te objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shendetsore, kulturore, sportive, vepra te kullimit per vaditje, infrastrukture, sherbime komunale e urbane, ndertime rrugore e hekurodhore, projektme te objektev te sipertreguara.
- e. blerje dhe shitje, dhënie dhe marrja me qira trojesh, ndertesa dhe pasuri te paluajtshme.
- f. Prodhim, transmetim, shperndarjen dhe shitjen e energjise elektrike.
- g. Transport udhetaresh me taksi si dhe çdo veprimtari tjetër te lejuar nga ligji.
- h. Seleksionim të mbetjeve urbane dhe riciklim, përpunim të mbetjeve të riciklueshme, kompostim të mbetjeve organike.
- i. Projektim objektsh ekonomike, civile, industriale, etj.
- j. Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi sipas kategorive A: 1,23 etje.
- k. Vleresimin e pasurive te paluajtshme.
- l. Hartimi i raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditimin mjedisor, per hartimin e ekspertizave per problem mjedisor.
- m. Veprimtari ne fushen e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te çdo lloji, hartimi i akteve te ekspertizes per zjarret e rena.
- n. Sherbim konsulence, studime urbane, sherbime ne planifikim urban, transporti, topografike, gjeologjike, hidrogjeologjike, infrasrukture ambientale, projektim objektsh civile, arsimore, sportive, industriale, bujqesore ushtarake, infrastrukture.
- o. Import, eksport i mallrave industriale materiale ndërtimi, hidrosanitare, makineri te çdo lloji, si dhe shitjen dhe blerjen e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashtë Shqipërisë, mallrave ushqimore, bujqësore, materiale druri të përpunuar e të papërpunuar, grumbullim e përpunim të bimëve mjekësore, tregtim mallrash të çdo lloji me shumicë e pakicë, transport nacional e ndërkombëtare të mallrave dhe pasagjerëve, komisioner, agjent tregtare e doganore, tregtim import eksport të mallrave me shumicë e pakicë, elektrike, elektronike, sanitare.
- p. Grumbullim transportim i ujrave te ndotura



- q. Shërbime marketing, marrëdhënieve me publikun, ekspertizë shitje, menaxhimi i pronës, ndërmjetësim qiradhënie, shërbime të studimit të tregut, shërbime të pas shitjes, ndjekja e pagesave të klientëve, mbajtja dhe menaxhimi i data bazës së klientëve, mbajtja e marrëdhënieve me klientët.
- r. Shoqëria mund të kryej çdo operacion tregtar, e që lidhen me pasuri të luajtshme dhe te paluajtshme; operacione financiare dhe kredi marrje, të japë garanci të tretëve, si edhe të blejë dhe shes, ose marr me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, por gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- s. Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- t. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 Lekë (njqind lekë), i ndarë në 2 kuota të zotëruar në masën.
- 6.2 Kuotat e Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortaket me të dhënat e mëposhtme:
- o 1 (një) Kuote me vlere 50 (pesëdhjetë) Leke-, qe përfaqëson 50% te Kapitalit themeltar te Shoqërisë do te zotërohet nga Z. Aleksandër FRANGAJ, i datëlindjes 04.10.1968, lindur në Zejmen, Lezhë dhe banues në adresën: Kompleksi Rolling Hills, Mullet, Tiranë, identifikuar me anë të pasaportës me numër personal G81004099S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Dhe

- o 1 (një) Kuote me vlere 50 (pesëdhjetë) Leke-, qe përfaqëson 50% te Kapitalit themeltar te Shoqërisë do te zotërohet nga Shoqeria Balfin Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka

Neni 7 –Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 të Statutit.

Neni 8 – Administratori/ët

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në emërim dhe/ose në këtë Statut
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 8.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

"Z. Roland Sinjari shtetas shqiptar, lindur në Lushnje, më 08.11.1984, banues në adresën: Rruga "Artan Lenja, Tiranë , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 027800715 dhe numër personal I41108079R madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar."

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 – Dispozita të Fundit

- 10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.



Për

AS CONSTRUCTION Sh.p.k

ORTAKET

Balfin Sh.p.k

Melmeriki Frangaj

Aleksandër Frangaj

Aleksandër Frangaj

Edlira Muka

Edlira Muka

Administratore

